



Raport nga procesi i konsultimit publik me qytetarë për Dëgjimin Publik për Draft-Buxhetin e Komunës së Istogut për vitet 2026–2028

Institucioni organizator: Komuna e Istogut

Drejtorja përgjegjëse: Drejtorja për Buxhet dhe Financa

Komuna e Istogut ka organizuar dëgjim publik me qytetarë lidhur me Draft-Buxhetin e Komunës për vitet 2026–2028, me qëllim të informimit të publikut dhe përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Dëgjimi publik është organizuar në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe pjesëmarrje publike, si dhe në kuadër të praktikave të rregullta të konsultimit me qytetarë për dokumentet me rëndësi strategjike.

Takimi është shpallur përmes uebfaqes zyrtare të Komunës së Istogut, rrjeteve sociale dhe mediave lokale, duke u mundësuar qytetarëve pjesëmarrje të hapur dhe dhënie të komenteve.

Gjatë takimit, përfaqësuesit komunalë prezantuan strukturën e Draft-Buxhetit, prioritetet kryesore të shpenzimeve, investimet kapitale të planifikuara dhe programet që synojnë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale. U theksua se sugjerimet e qytetarëve janë pjesë e rëndësishme e këtij procesi.

Qytetarët pjesëmarrës parashtruan komente dhe kërkesa lidhur me infrastrukturën rrugore, furnizimin me ujë të pijshëm, ndriçimin publik, përkrahjen për familjet në nevojë dhe investimet në arsim. Të gjitha komentet janë evidentuar dhe do të shqyrtohen gjatë finalizimit të buxhetit.

Në takimin e mbajtur me 16.09.2025 qytetarët pjesëmarrës kanë kërkuar që kërkesat e tyre të jen pjesë e Draft-Buxhetit të Komunës për vitet 2026–2028